



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:216233

Datë: 21.11.2024

Numri i dokumentit: 06486451

C.nr.611/2014

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Egzon Mujaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses G.I., nga P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S.J., avokate nga P., kundër të paditurit B.S., nga P., me bazë juridike ndarje e pasurisë së përbashkët, me vlerë të kontestit 26,840€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datë 12.11.2024, në prezencë të përfaqësueses së paditëses dhe palës së paditur, me datë 21.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditëses G.I., nga P., ashtu që DETYROHET i padituri B.S., nga P., që në emër të vlerës së stolive të arit dhe rrobave personale të nusërisë dhe të përditshme, t'ia paguajë paditëses shumën në lartësi prej 9,800€ (nëntë mijë e tetëqind euro), si dhe t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës, në lartësi prej 374.4 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II. REFUZHET kërkesëpadia e paditëses që pala e paditur në emër të të ardhurave personale, t'ia kompensojë shumën prej 14,400€, në emër të qirasë shumën prej 2,640 €, si dhe t'i kthehen librat e gjuhës dhe letërsisë shqipe nga biblioteka e saj, SI E PABAZUAR.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes përfaqësueses së autorizuar, ka paraqitur padi ndaj të paditurit, për ndarje të pasurisë së përbashkët, ndërsa me parashtresën për precizim të padisë dhe kërkesës së saj, të dates 14.02.2019, ka kërkuar nga gjykata që të obligohet i padituri që në emër të stolive të arit, gjësendet personale të nusërisë dhe të përditshme, të cilat me rastin e martesës paditësja i ka

sjellë me vete, e të cilat janë cekur edhe në ekspertizën e datës 01.12.2016, t'ia kompensojë vlerën e tyre në lartësi prej 9,800€, po ashtu ka kërkuar që të detyrohet i padituri që në emër të të ardhurave personale të përbashkëta të realizuara përgjatë 8 viteve martesë t'ia paguajë shumën prej 14,400€, në emër të qirasë nga data 01.03.2017, shumën e përgjithshme prej 2,640€, si dhe t'ia kthej paditëses bibliotekën e cila është cekur në ekspertizë, e cila nuk i takon fëmijëve por paditëses nga studimi i gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Gjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesja e autorizuar e paditëses ka deklaruar se palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë me datë 26.07.2002, e cila martesë është zgjidhur sipas aktgjykimit me shenjë C.nr. 234/2013, me datë 06.01.2014. Gjatë martesës paditësja ka kontribuar në përkujdesjen ndaj fëmijëve dhe ndaj të paditurit, ku së bashku me të kanë punuar në një dyqan familjar të quajtur "Festa Market", që gjendet në M., Komuna e P. dhe paga e paditëses ka qenë në shumë prej 300€, të cilën shumë paditësja asnjëherë nuk e ka realizur, ngase janë shpenzuar për familje, po ashtu ka shtuar se paditësja është obliguar që bashkë me dy fëmijët e saj të mitur të sigurojë vendbanim për veten dhe fëmijët e saj, andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e precizuar të paditëses ta aprovojë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për përpilim të padisë shumën prej 208€, për dy seanca të mbajtura shumën prej 270 €, si dhe për precizim të padisë shumën prej 208€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

I padituri me përgjigje në padi si dhe në seancën e shqyrtimit kryesor ka theksuar se e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses pasi që personalisht nuk ka asnjë pasuri të paluajtshme që figuron në emrin e vet personal, po ashtu ka theksuar se pikën e parë dhe të dytë që është në kuadër të pikës së parë të precizimit të padisë dhe kërkesës së saj, nuk e kundërshton lidhur me stolitë e arit dhe gjësendet personale të paditëses, ndërsa pikën e tretë dhe të katërt që kanë të bëjnë me të ardhurat personale dhe pagesën e qirasë ka shtuar se e kundërshton si të pabazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 12.11.2024, sipas propozimit të palëve ka administruar provat relevante dhe atë: Vërtetimi nga Komuna e Prishtinës, me numër 10-435-41470 i datës 19.02.2016, Certifikata nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, me numër 11-953-43988/16 e datës 23.02.2016, Kartela e punë kërkuarit lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, Pasqyra e kontributeve pensionale e datës 15.01.2010, Pasqyra e mbajtjes në burim dhe pagimi të tatimit e datës 14.01.2005, Njoftimi mbi shuarjen nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), e datës 11.11.2011, Deklarata e datës 17.11.2016, Ekspertiza financiare punuar nga eksperti R.B., e

datës 01.12.2016, Pasqyra nga trusti e datës 18.05.2017, Procesverbali i datës 08.06.2017, ku janë dëgjuar palët ndërgjyqëse dhe Aktgjykimi nga Gjykata Themelore në Prishtinë, me numër C.nr.234/2013, e datës 06.01.2014.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se në këtë çështje juridike kontestimore kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjyqëse, nuk rezulton të jetë kontestues fakti se të njëjtit kanë qenë në bashkësi martesore, gjegjësisht kanë qenë të kurorëzuar nga data 26.07.2002, ndërkaq kjo martesë është zgjidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, me shenjë C.nr.234/2013, të datës 06.01.2014, si dhe nga kjo martesë palët ndërgjyqëse kanë 2 fëmijë të përbashkët dhe atë L.S.1, i lindur me datë ... si dhe L.S.2., i lindur me datë ..., të cilët në momentin e zgjidhjes së martesës i janë besuar në ruajtje, edukim dhe kujdes nënës së tyre - këtu paditëses, ndërsa babai - këtu i padituri ishte obliguar në pagesën e alimentacionit.

Nuk ishte po ashtu kontestues fakti se paditësja kishte sjellë me vete në martesë gjësende personale dhe stoli të arit me vlerë prej 9,800€, por kontestuese mes tyre ishte fakti nëse paditëses i takon shuma në lartësi prej 14,400€, në emër të të ardhurave personale, si dhe shuma në lartësi prej 2,640 €, në emër të qirasë.

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të financiar R.B, gjykata vërtetoi faktin se mbështetur në të dhënat e deklaruara nga paditësja dhe i padituri, investimet e deklaruara si të përbashkëta, eksperti konsideron se nuk janë kontribut i palëve ndërgjyqëse, për faktin se me të ardhurat e realizuara nga afarizmi i një dyqani tregtar familjar, përkatësisht me të ardhurat nga pagat, nuk mund të akumulohen mjete në lartësi të investimeve të deklaruara, nga kjo rrjedh se investimet mund të trajtohen si kontribut i prindërve të të paditurit e jo i palëve ndërgjyqëse, si dhe eksperti konkludon se sa i përket investimeve për anekset e shtëpisë, garazhin, mobilimin ato janë kontribut i prindërve të të paditurit. Ashtu që, nga të dhënat e sipërme rezulton se paditësja dhe i padituri përgjatë periudhës martesore kanë realizuar të ardhura në shuma të barabarta, këto të dhëna reflektojnë faktin se palët ndërgjyqëse përgjatë periudhës martesore kanë kontribuar me paga në shkallë 50%-50%, që nënkupton njëkohësisht edhe të drejtën në tërë pasurinë e krijuar me kontribut të përbashkët. Si përfundim, vlera e gjësendeve prej ari, bizhuteritë, veshmbathjet e paditëses si dhe gjësendet tjera që kanë mbetur tek i padituri, e të cilat kanë qenë të paditëses por me rastin e ndarjes nuk i është mundësuar tërheqja e tyre, është në vlerë prej 10,000€ (vlera është deklaruar nga vet paditësja, sepse eksperti vlerësues nuk ka pasur mundësi që ato t'i shoh dhe eventualisht t'i vlerësoj me ndonjë çmim tjetër), ku në ekspertizë është e përshkruar një tabelë me këtë përmbajtje: 3 lira të arit, me vlerë 600€, Komplet i arit të bardhë, qafore dhe

unazë - 500€, komplet i arit, qafore dhe e dorës – 2,000€, 4 zingjirë të arit – 400€, 1 qystek i arit -1,000€, 5 rrrathë të arit të dorës – 500€, 1 hallhalle e dorës së arit – 500€, 1 unazë e fejesës – 200€, 2 unaza dore – 400€, 12 unaza të arit – 600€, bizhuteri të ndryshme – 100€, rroba personale nusërie dhe të përditshme – 3,000€, si dhe biblioteka e fëmijëve – 200€, gjithsej në vlerë prej 10,000€.

Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare si të besueshme, për pjesën e aprovuar të kërkesës së paditëses meqenëse për njëjtën palët ndërgjyqëse nuk kishin vërejtje, duke u bazuar në pohimin e të paditurit.

Gjykata në shqyrtimin kryesor të datës 08.06.2017, në cilësinë e palës e ka dëgjuar paditësen e cila ka deklaruar se ka qenë në bashkësi martesore me të paditurin e cila ka zgjatur deri me datën 11.11.2010, nga kjo martesë kanë dy fëmijë, po ashtu ka theksuar se në vitin 2002, ka themeluar për herë të parë marrëdhënien të punës në minimarket ku investimet për fillimin e kësaj veprimtarie janë bërë nga ana e babait të të paditurit, po ashtu ka shtuar se gjatë kësaj kohe sa ka qenë në marrëdhënie pune nuk është kompensuar me pagë përkundër faktit se ka pasur kontratë si shitëse.

Po ashtu në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 08.06.2017, në cilësinë e palës është dëgjuar pala paditur i cili ka deklaruar se në vitin 2002, me ndihmën dhe kontributin e prindërve, kanë hapur marketin, ku ka punuar një kohë së bashku me paditësen mirëpo për shkak të angazhimeve të saj në studime dhe pasi që ka qenë e sëmurë, pastaj ka punuar vetëm me një punëtore tjetër të angazhuar, si dhe i gjithë fitimi i realizuar nga ky market nuk ka qenë i mjaftueshëm për ekonominë familjare dhe gjithë kohën janë ndihmuar nga prindërit e të njëjtit. Nga provat e administruara dhe atë nga vërtetimi nga Komuna e Prishtinës, me numër 10-435-41470, i datës 19.02.2016, si dhe certifikata nga Agjencia Kadastrale e Kosovës me numër 11-953-43988/16, e datës 23.02.2016, gjykata gjeti se i padituri nuk ka dhe nuk posedon pronë të regjistruar në emrin e tij.

Ndërsa nga njoftimi mbi shuarjen i datës, gjykata vërtetoi faktin se biznesi NT “F.”, me pronar B.S., ishte shuar, ndërkaq nga pasqyrat e kontributit dhe i tatimit të lëshuara nga ATK, me datë 14.01.2005 si dhe 14.10.2010, gjykata gjeti se paditësja dhe i padituri kanë paguar kontribute dhe tatim në pagë nga punëdhënësi NT “F.”.

Meqenëse pika I e kërkesëpadisë së precizuar me parashtresën e datës 14.02.2019, e cila kishte të bënte me gjësendet personale të paditëses, në vlerë prej 9,800 €, nuk u kundërshtua nga ana e të paditurit i cili në shqyrtimin kryesor të datës 12.11.2024, ndër të tjerash ka deklaruar se pikën e parë dhe të dytë që është në kuadër të pikës së parë të precizimit të padisë dhe kërkesës së saj, nuk e kundërshton lidhur me stolitë e arit dhe gjësendet personale të paditëses, atëherë gjykata duke vepruar sipas nenit 321 par.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore i cili parasheh se “Nuk

ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor”, si dhe në nenin 46 par.1 i Ligjit për Familjen i Kosovës, me të cilin është e paraparë që “Pasuria e cila i ka takuar bashkëshortit në çastin e lidhjes së martesës do të mbetet pasuri e veçantë e tij”, e që rrjedhimisht gjësendet personale të paditëses përbëjnë pasuri të veçantë ngase të njëjtat i ka sjellë me vete kur është martuar sipas deklaramit të saj, fakt ky i cili nuk është kundërshtuar nga i padituri, e duke marrë po ashtu parasysh ekspertizën financiare të datës 01.12.2016, në të cilën është konstatuar se vlera e gjësendeve personale të paditëses është në lartësi prej 10,000€, gjykata vendosi brenda kërkesës së palës paditëse duke e aprovuar shumën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, meqenëse kjo kërkesë është pohuar nga pala e paditur.

Fakt vendimtar për tu vërtetuar në këtë çështje juridike mbeten vërtetimi i faktit nëse gjatë bashkësisë martesore të palëve ndërgjyqëse është krijuar pasuri e përbashkët, e në këtë kuptim nëse ka ardhur në shprehje kontributi i paditëses në krijimin e kësaj pasurie, në mënyrë që të njëjtës t'i takojë e drejta e kompensimit sipas kërkesës së parashtruar me padi, si dhe kompensimi në emër të banimit me qira.

Duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Familjen i Kosovës Nr.2004/32, fazën gjatë së cilës mund të kërkohet ndarja e pasurisë së përbashkët, respektivisht subjektet të cilët janë të autorizuar të iniciojnë një procedurë të tillë e përcakton dispozita e nenit 56 të Ligjit, e cila parasheh që "Ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve mund të kërkohet gjatë martesës dhe pas pushimit të saj. Të drejtën që të kërkojnë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët kanë bashkëshortët, trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur ose të bashkëshortit të shpallur të vdekur, si dhe kreditori i njërit prej bashkëshortëve, nëse kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet nga pasuria e pjesëtuar e atij bashkëshorti".

Neni 47 i këtij ligji, i cili ka përcaktuar definicionin e pasurisë së përbashkët i cili është riformuluar në bazë të nenit 1 të Ligjit Nr.06/L-077 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës. Kjo dispozitë parasheh që "Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me kontribut të përbashkët gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë". Nga interpretimi i kësaj dispozite, rezulton se për të ardhë në shprehje ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve duhet të përmbushen dy kritere bazike, dhe atë në mënyrë kumulative: 1) Gjatë ekzistimit të bashkësisë martesore duhet të krijohet pasuri e re apo të shtohet vlera e ndonjë pasurie ekzistuese dhe 2) krijimi apo shtimi i kësaj pasurie duhet të jetë rezultat i kontributit të përbashkët të bashkëshortëve. Se çka konsiderohet kontribut i përbashkët i bashkëshortëve e sqaron paragrafi 2 i të njëjtës dispozitë, ku përcaktohet që "Kontribut i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimit të martesës konsiderohet: të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort; ndihma e bashkëshortit e afuar bashkëshortit tjetër, siç është kujdesi për fëmijët, udhëheqja e punëve të

shtëpisë, përkujdesja dhe mirëmbajtja e pasurisë, si dhe çfarëdo forme tjetër e punës dhe e bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët". Siç vërehet nga interpretimi i dispozitës së lartcekur, vlerësimi i kontributit të përbashkët nuk kufizohet vetëm në vlerësimin e të ardhurave personale apo të hyrave të secilit bashkëshort, por vlerësohet edhe ndihma apo kontributi në aspektin e kujdesit ndaj fëmijëve, udhëheqjes së punëve të shtëpisë dhe çfarëdo forme në drejtim të administrimit, mirëmbajtjes apo shtimit të pasurisë.

Këto dy rrethana konsiderohen të barasvlefshme me rastin e vendosjes nga ana e Gjykatës në kuptim të nenit 54 të Ligjit, ku parashihet që "Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata." Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët. Gjykata kompetente vendos po ashtu në rast të mosmarrëveshjes lidhur me pjesët e pasurisë së bashkëshortëve të paraparë sipas këtij neni." Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi e cila kërkesë konsiston në obligimin e të paditurit që paditëses nga puna e saj, si shitëse në dyqanin e tyre "F.M", në fshatin M., në emër të kontributit të saj, t'ia paguajë shumën prej 14,400€, ngase një kërkesë e tillë nuk është specifike për karakterin e kësaj procedure, për faktin se bashkësisë martesore, në këtë rast i japet karakter nga marrdhënia e punës, e që është parim themelor juridik që martesë dhe bashkësi jashtëmartesore, nga e drejta familjare nuk duhet të kuptohen me themelimin e marrëdhënies së punës për njërin nga bashkëshortët, rrjedhimisht detyrim për bashkëshortin tjetër që në rast të zgjidhjes së martesës apo pushimit të bashkësisë jashtëmartesore të ofrojë kompensim, andaj kjo kërkesë si e tillë e palës paditëse ka të bëjë me detyrimet që dalin nga bashkësi martesore dhe nuk mund të gjykohet asnjë lloj kompensimi për paditësen në emër të kontributit të dhënë në bashkësinë martesore për një periudhë të caktuar, kur konstatohet se nga kjo bashkësi nuk është krijuar pasuri e përbashkët, ndaj si e tillë edhe është refuzuar.

Po ashtu gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, lidhur me kërkesën e palës paditëse për pagesë të qirasë, ngase paditësja gjykatës nuk i ka prezantuar asnjë provë me të cilën do dëshmohej se e njëjta ka jetuar apo jeton me qira, e po ashtu edhe për faktin se kjo kërkesë si e tillë nuk mund të cilësohet si kontribut në bashkësinë martesore të bashkëshortëve lidhur me marrëdhëniet pasurore të tyre, andaj duke u bazuar në nenin 7, paragrafi 1, të LPK-së, ku është përcaktuar se "palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet, në të cilat i

mbështesin kërkesat e tyre dhe të propozojnë prova, me të cilat vërtetohen ato fakte” dhe nenin 319, paragrafi 1, të njëjtit Ligj, ku thuhet se “palët ndërgjyqëse kanë për detyrë të provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkesat dhe pretendimet e tyre”, gjykata e refuzoi këtë kërkesë si të pabazuar. Po ashtu gjykata refuzoj si të pabazuar edhe kërkesën e paditëses për kthimin e librave nga studimi i gjuhës dhe letërsisë shqipe ngase e njëjta nuk ka bashkangjitur asnjë listë e cila do dëshmonte titujt apo provë se kush është pronar i librave të pretenduar me padi, po ashtu edhe për faktin se pala e paditur ka theksuar se kjo kërkesë është në kuadër të pikës së parë të cilën e ka pohuar.

Mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar si dhe nga arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë gjen se në rastin konkret kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë, për çka edhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për pjesën e aprovuar të cilën e ka pohuar pala e paditur, po ashtu gjykatë me rastin e vendosjes i vlerësoi të gjitha provat dhe faktet tjera, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur, t’i bartë shpenzimet e procedurës Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 449 dhe 452 e lidhur me nenin 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të përfaqësueses së autorizuar të paditëses, për padi 104€, për dy seanca të mbajtura nga 135.20 € (sipas nr. tarifor 6 dhe 7, të tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, për kontestet me vlerë mbi kontestet e vlerës së vogël).

Andaj duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.611/2014, datë 21.11.2024

Gjyqtari  
Egzon Mujaj

#### UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.